



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN
BELEDIYESI

Drejtoria e Arsimit/Direkcija za Obrazovanje/Eğitim Müdüriyeti

Në bazë të Ligji për Zyrarët Publikë, Nr.06/L-114, neni 67 dhe 68, Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212 neni 8, Normativit të MASHT Nr.5/2021, neni 8 pika 6, Udhëzimit Administrativ të MPMS, Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe mbështetur në projektin “Përfshirja e fëmijeve me aftësi të kufizuar në shkollat e targetuara në Kosovë” i cili implementohet nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar në Kosovë, përkrahët nga UNICEF në Kosovë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian, Drejtoria e Arsimit rishpallë këtë :

RISHPALLJE E KONKURSIT PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS

Institucioni: Komuna e Gjiçanit
Drejtoria: Drejtoria Komunale e Arsimit
Lloji i pozitës: Shërbimit Publik
Numri i pozitave: 4 (katër)
Orari i punës: 40 orë në javë
Titulli i mbikëqyrës: Drejtori i Shkollës
Grada/Koeficienti: Paga bruto : 416.86 Euro
Kohëzgjatja e kontratës : Me kohë të caktuar, për 18 muaj.

Nr.	Institucioni	Vendet e Punës	Vendi i lirë/ Në kohë të caktuar	Numri i V. të Punës
	IEAA	Asistent për fëmijët/nxënësit nevoja të veçanta	Në kohë të caktuar	4

Kjo shpallje mbështetet në kuadër të projektit “Përfshirja e fëmijeve me aftësi të kufizuar në shkollat e targetuara në Kosovë” i cili implementohet nga Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar në Kosovë, përkrahët nga UNICEF në Kosovë, me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Projekti zgjatë 18 muaj.

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet duke u mbështetur në Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr. 05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm neni 8 pika 6 si dhe Udhëzimit Administrativ të MPMS, Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik.

Kandidati/ja i/e interesuar duhet t’i plotësoj këto kushte :

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë të kryer niveli 5-të (Post sekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore. Në mungesë të tyre përparësi kanë kandidatët të cilët janë duke e ndjekur niveli 5-të (Post sekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta arsimore.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje.

Dokumentet që duhet të dorëzohen për aplikim:

- Formulari i aplikimit i cili merret dhe dorëzohet në Zyrën për Shërbime me Qytetarë;
- Diploma/ dokumenti për përgatitjen profesionale e noterizuar;
- Dëshminë për përvojën e punës në arsim;
- Certifikatë që nuk është nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit.

Vërejte : Kandidatët që pranohen në këto vende pune janë të obliguar të sjellin certifikatën mbi gjendjen shëndetësore të tyre para lidhjes së kontratës së punës (nuk kërkohet në dokumentacion të aplikimit).

Informata të përgjithshme:

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 8 ditë nga data : 14.12.2022 deri me : 21.12.2022

Të gjithë kandidatët e interesuar, aplikacionet mund t'i marrin në formë fizike në Qendrën për Shërbim me Qytetarë, apo t'i shkarkojnë nga web faqja zyrtare e Komunës së Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> dhe portali shtetëror <https://konkursi.rks-gov.net/> dhe të plotësuara t'i dorëzojnë në Qendrën për Shërbim me Qytetarë në Komunën e Gjilanit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Dokumentacioni dorëzohet në kopje, pasi që i njëjti pas përfundimit të procedurave të rekrutimit nuk kthehet.

Të gjithë kandidatët të cilët kanë mbaruar shkollimin jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës e që konkurrojnë për këto vende të punës, duhen që diplomat e tyre të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, nr. 8/2010.

Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret dhe hyjnë në listën e ngushtë do të ftohen në testim me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë.

Kandidatët të cilët gjatë testit me shkrim marrin 50% të pikëve do të ftohen në intervistë me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri në 100 pikë.

Për kohën dhe vendin e mbajtjes së testit dhe intervistave, kandidatët do të informohen përmes njoftimit i cili do të publikohet në ueb faqen e Komunës dhe tabelat e objektit të Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Rezultatet përfundimtare të vlerësimit do të shpallen në web faqen zyrtare të komunës së Gjilanit <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> dhe në linkun: <https://konkursi.rks-gov.net/>.

Në rast të ndonjë nevoje eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave të publikuara me rastin e shpalljes së rezultateve.

Drejtoreshë e DKA-së

Albana Demiri

